



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4838 / Prot. 1

Tiranë, më 19. 7. 2022

UDHËZIM

Nr. 20, datë 19. 7. 2022

PËR
PËRCAKTIMIN E LËNDËVE MËSIMORE QË ZHVILLOHEN NË GJUHËN SHQIPE
DHE NË GJUHËN AMTARE NGA NXËNËSIT E PAKICAVE KOMBËTARE NË
ARSIMIN BAZË NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 të nenit 10 dhe të nenit 26 të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në institucionet arsimore parauniversitare, ku mësojnë nxënësit e pakicave kombëtare, sipas kuadrit ligjor në fuqi, lëndët mësimore që zhvillohen në gjuhën amtare të pakicave kombëtare dhe në gjuhën shqipe, të jenë:
 - a) Në gjuhën amtare të pakicave kombëtare:

Nr.	Lënda	Klasa
1.	Gjuhë amtare	I-IX
2.	Histori	IV-VIII
3.	Histori amtare	IX
4.	Gjeografi amtare	VIII
5.	Gjeografi	VI-VIII
6.	Dituri natyre	I-V
7.	Matematikë	I-V
8.	Biologji	VI-IX
9.	Edukim për shoqërinë	I-II
10.	Art pamor	I-VIII
11.	Muzikë	I-IX
12.	Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti	I-IX
13.	Qytetari	III-IX
14.	Teatër	V-VI
15.	Aftësim teknologjik praktik	IV-VI
16.	Kërcim	II-III

b) Në gjuhën shqipe:

Nr.	Lënda	Klasa
1.	Gjuhë shqipe	I-IX
2.	Histori e Shqipërisë	IX
3.	Gjeografi e Shqipërisë	IX
4.	Matematikë	VI-IX
5.	Fizikë	VI- IX
6.	Kimi	VIII-IX
7.	TIK	IV-IX

2. Në lëndët “Art pamor” dhe “Muzikë”, temat mësimore që kanë lidhje me kulturën shqiptare, të zhvillohen në gjuhën shqipe.
3. Në lëndën “Qytetari”, temat mësimore që kanë lidhje me njohjen dhe funksionimin e institucioneve shtetërore të Republikës së Shqipërisë, të zhvillohen në gjuhën shqipe.
4. Kurrikula në bazë shkolle mund të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe/ose në gjuhën amtare.
5. Në institucionet arsimore parauniversitare, ku mësojnë nxënësit e pakicave kombëtare, kur nuk plotësohen kushtet për zhvillimin e lëndëve mësimore në gjuhën amtare, sipas përcaktimeve ligjore, në klasat VI-IX, lëndët mësimore mund të zhvillohen në gjuhën shqipe.
6. Në institucionet arsimore parauniversitare, ku mësojnë nxënësit e pakicave kombëtare, punohet me programet dhe tekstet e përgatitura në Republikën e Shqipërisë, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën amtare.
7. Dokumentacioni shkollor, si amzat, regjistrat, dëftesat dhe shkresat e ndryshme plotësohen në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
8. Përcaktimi i planit mësimor dhe programeve mësimore për nxënësit e pakicave kombëtare bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.
9. Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, Nr. 14, datë 3.9.1994, “Për arsimin 8-vjeçar në gjuhën amtare të personave të pakicës”, shfuqizohet.
10. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”

MINISTËR

Evis KUSHI

